

FILMI DOKUMENTAR

Vetë fjala dokumentar na tregon se kemi të bëjmë me dokumentimin e një historie. Për ta dokumentuar një send na duhet kohë. Filmi dokumentar tek disa njerëz nuk ka dallim të madh nga reportazhi, por e vërteta është se ekziston një dallim shumë i madh. Filmi dokumentar përfshinë jetën sociale të një individi apo një grupi njerëzish, populli apo grupi idealistësh. Në film dokumentar kemi tema të cilat fillojnë me pyetjet: kush, pse, si? Filmi dokumentar duhet të ketë një temë dhe të na sjell një rrëfim që është bazuar në realitet. Të realizosh filmin dokumentar duhet të fillosh nga:

Ideja, tretmani (apo shkalla), skenari i xhirimit, skenari i montazhit dhe skenari rrëfyes apo narrativ.

Ideja

Të gjithë e dimë se çka është ideja. Është koncepti i saktë i cili përshkruan të gjithë strukturën e filmit.

Tretmani

Tretmani thjesht është përmbledhje e shkurtë e propozimit për film apo udhërrëfyes i cili shpjegon filmin në përgjithësi. Detyra e tretmanit është të shpjegojë apo qartësojë propozimin dhe progresin e filmit me agjensionin i cili do ta financojë, goftë ai televiziv, produksion i pavarur apo institucion. Tretmani duhet të shkruhet thjesht por me fjali shumë të pasura.

Skenari i xhirimit

Skenari i xhirimit është plani miratues. Zakonisht përmban përshkrimin e plotë të rrëfimit dhe renditjen vizuale të filmit. Skenari i xhirimit gjithashtu këshillon regjisorin çka të xhiroj dhe çka do të përdoret gjatë xhirimit e gjithashtu edhe propozimin e buxhetit të duhur. Siç përmendëm më parë, po ashtu ndihmon kameramanin që të përcaktojë se me çfarë kamere, objektivash (lenta) apo ndriçimi duhet të realizohet.

Skenari i montazhit vizuel

Skenari i montazhit, apo skenari vizual mund të jetë i ngjashëm me atë të xhirimit apo diçka krejt tjetër. Zakonisht regjisorin ulet së bashku me montazhistin e filmit dhe inspekton apo shikon materialin e xhiruar. Kjo ndihmon regjisorin që të vendosë që të hedhë, shtojë, apo ndryshojë renditjen e filmit për nevoja të rrëfimit. Shpeshherë skenari i montazhit pasuron idenë dhe është udhërrëfyes për montazhistin. Ky pra quhet skenari i montazhit. Ajo çka duhet të theksohet është se gjatë montazhit mund të ketë ndryshime apo largim nga tretmani apo skenari, prandaj më parë e cekëm se tretmani duhet të shkruhet thjesht por me fjali shumë të pasura.

Skenari rrëfyes

Skenari rrëfyes nuk është me të vërtetë skenar por më tepër rrëfimi final. Tekst i cili do të lexohet nga lektori përmbi material. Në shumicën e rasteve në filmat dokumentarë biografik. Skenari rrëfyes gjithashtu është sikurse dialogu i cili tregon atë që nuk mund ta shohim.

Shpeshherë shkruhet në fund pas montazhit vizuel. Skenari rrëfyes realizohet veçmas, duke regjistruar zërin gjatë leximit të lektorit dhe pastaj lidhet me materialin vizuel. Megjithatë mund të ketë ndryshime nëse skenari rrëfyes është shkruar para montazhit vizuel sepse mund të mos përputhet saktësisht me kohëzgjatjen e sekuencave. Pas lidhjes së rrëfimit të lektorit dhe materialit vizuel, punën e përfunduar mund ta quajmë produkt final apo film dokumentar.

REPORTAZHI

Reportazhi dallon nga filmi dokumentar edhe nga mënyra e zhvillimit të temës, rrëfimit dhe po ashtu edhe nga kohëzgjatja. Reportazhin mund ta realizojmë brenda një kohe të shkurt. Nga 2-3 orë të një dite deri në 3 e më shumë ditë. Vetë fjala reportazh tregon se kemi të bëjmë me raportim. Reportazhi realizohet më shumë për kërkesa të televizionit dhe duhet të jetë i freskët. Në reportazh temën kryesore e zë ndonjë problem social i një grupi njerëzish apo personi, ku ngjarja apo tema është e freskët për shikuesin. P.sh.: si u zhvilluan dhe mbaruan demonstratat, greva e punonjësve, si duket jeta e dikujt pas një rasti tragjik, kataklizmi natyror, etj.

REGJIA APO REALIZIMI

Regjia apo realizimi? Kjo është pyetje morale të cilën duhet t'ia nënshtrojë vetes regjisori i filmave dokumentarë. Shpeshherë ndodhë që në filma dokumentarë të prekshëm, si viktimat e luftës, vdekja e personazhit, etj. përdoret termi *Regjia*. Profesori A. Titkoë, gjithmonë sugjeronte që në këto raste është mirë të përdoret *Realizimi*. Pse? *Sepse nuk keni bërë ju regjinë e vdekjes së personazheve por vetë Zoti*. Pra, ju në ato momente duhet të jeni realizues të filmit e jo regjisor. Respekti ndaj personazheve, familjarëve të tyre dhe shikuesit duhet t'ju shtyj që ta ndërroni titullin nga regjisori në realizues.